



**Consolato d'Italia  
Scutari**

**PUNE E PAVARUR**

Dokumente qe duhet te paraqiten:

- **Pashaporta**  
(Pashaporta duhet te jete e vlefshme te pakten tre muaj mbas skadences se vizes se kerkuar; pashaporta duhet te jete e firmosur nga titullari).
- **Fotokopje e pashaportes**
- **1 fotografi**
- **Formular i plotesuar ne çdo pjese te tij**
- **Disponibiliteti i nje banese te nevojshme**
- **Autorizimi paraparak i Kuestures kompetente (Nulla osta)**
- **Aktivitet te pavarur per llogari te shoqerise ose te entit**  
Nese vizekerkuesi zhvillon aktivitet te pavarur per llogari te nje shoqerise ose enti qe vepron ne Itali, duhet te paraqiten keto dokumenta:  
a) Kontrata, e shoqeruar, ne rast se eshte e firmosur nga ndermarrja italiane, me çertifikaten e regjistrimit ne regjistrin e ndermarrjeve, dhe ne rastin e nje komisioneri te huaj, me te njejten çertifikate analoge te noterizuar nga Kancelaria Konsullore.  
b) nje deklarate formale pergjegjesie\* e perfaqesuesit legal te shoqerise ose te entit sipas se ciles midis vizekerkuesit dhe shoqerise apo entit nuk do te lidhet asnje marredhenie pune me pagese. Kjo deklarate duhet te noterizohet nga Drejtoria Rajonale e Punes ne Itali.  
c) deklaraten e komisionerit me te cilen i sigurohet punonjesit autonom nje kompensim ne nje shume me te madhe se niveli minimal i parashikuar nga ligji per perjashtimin nga kuota e shpenzimeve shendetesore (8263,3 Euro).  
d) Kopja e bilancit te fundit te depozituar prane regjistrin te ndermarrjeve ne rastin e shoqerive me kapital, ose deklarimi i fundit i te ardhurave ne rast shoqerise personash ose ndermarrjesh individuale ose te nje komisioneri jo sipermarres.
- **Ndermarrje prodhuese ose aktivitet tregtar dhe artizanal**  
Nese vizekerkuesi kerkon te zhvilloje ne menyre te pavarur nje aktivitet te vetin prodhues, ose nje aktivitet tregtar ose artizanal, duhet te paraqese dokumentacionin qe tregon plotesimin e kerkesave: regjistrimi ne listat profesionale, autorizime ose licenza komunale, regjistrimi ne Dhomen e Tregtise, etj.
- **Ortak dhe administrator ne shoqeri ose kooperativa**  
Ne kete rast vizekerkuesi duhet te paraqese:  
a) çertifikaten e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin e ndermarrjeve  
b) kopje te deklarates formale te pergjegjesise\*  
c) deklaraten e perfaqesuesit legal te shoqerise qe te siguroje per ortakun ose per subjektin qe ka funksion ne shoqeri nje kompensim me te madh se niveli minimal i parashikuar nga ligji per perjashtimin nga kuota e shpenzimeve shendetesore (8263,3 Euro).  
d) Kopja e bilancit te fundit te depozituar prane regjistrin te ndermarrjeve ne rastin e shoqerive me kapital, ose deklarimi i fundit i te ardhurave ne rast shoqerise ose ndermarrjesh individuale ose te nje komisioneri jo sipermarres.
- **Ne fushen e spektakleve**  
a) Aktin kontraktual: origjinali dhe fotokopja e aktit kontraktual me firme te vertetuar nga administratori ose nga titullari i licences se ushtrimit  
b) Deklaraten e pergjegjesise: origjinali dhe fotokopja e deklarates se pergjegjesise e komisionerit e noterizuar nga zyra perkatese kompetente per punonjesit e spektakleve, qe ne baze te kontrates nuk do te vendoset asnje marredhenie pune e paguar  
c) Certifikate profesionale e leshuar nga Enti publik ose nga nje Institucion i kualifikuar privat shqiptar
- **Certifikate lindjeje, e perkthyer, e noterizuar dhe e legalizuar nga Ministria e Puneve te Jashtme shqiptare**

**I gjithë dokumentacioni i leshuar nga Autoritetet shqiptare, duhet të jetë i perkthyer dhe i legalizuar nga Ministria e Punëve të Jashtme shqiptare.**

- a. Kujtojme se duke filluar nga data 01/10/2003, kerkuesi i vizes duhet të paguaje koston e saj që në momentin e paraqitjes së kerkeses, pavaresisht nga leshimi apo jo i mevonshëm i vizes.**
- b. Zyra rezervon të drejten për të kerkuar paraqitjen e dokumenteve të tjera të mundshëm, në shtesë të atyre të treguar me sipër, të cilët do të mbahen si të nevojshëm, me qëllim vleresimin e leshimit të vizes.**
- c. Të gjithë dokumentet duhet të paraqiten në origjinale dhe në fotokopje.**
- d. Kerkesat e mangëta nga dokumentacioni i mesipër do të refuzohen menjëherë në sportel.**